

ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BALFIN REAL ESTATE SH.P.K
RRUGA DERVISH HIMA, PALLATI AMBASADOR 3,
KATI 21, AP. 163, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2, TIRANË, SHQIPËRI
NUIS: L81507052H

Vendim NR. 6
ASAMBLE E PERGJITHSME E SHOQËRISE

Sot, më datë 20.12.2019 (dy mijë e nëntëmbëdhjetë), në selinë e Shoqërisë BALFIN REAL ESTATE SH.P.K., regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L81507052H (më tej referuar si "SHOQËRIA"), me adresë Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, kati 21, Ap. 163, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, Shqipëri, u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **Balfin Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT K72223031K dhe seli në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Kati 11, Tiranë, përfaqësuar nga administratori i saj Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 03.02.1983, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e lëtënjoftimit me Nr. 025864525, - zotëruese e 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të saj, **(referuar edhe si: Ortaku i Vetëm);**
- **Z. Bers Hado** në cilësinë e këshilltarit ligjor të Balfin Sh.p.k;

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Z. Bers Hado, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit të mbledhjes. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

Meqenëse në mbledhje janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të **Shoqërisë**, mbledhja diskuton rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË BALFIN REAL ESTATE SH.P.K.

I. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË BALFIN REAL ESTATE SH.P.K.

Kryetari i Asamblesë në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës parashtroi se Ortaku i Vetëm ka kontribuar në para në shoqëri në një vlerë totale prej 112,100,000 LEK (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind mijë Lekë). Duke qenë se kërkohet kapitalizimi i kontributeve të dhëna nga Ortaku, lind nevoja për miratimin e rritjes së kapitalit nëpërmjet kontributit në para të Ortakut të Vetëm me një vlerë të përgjithshme prej 112,100,000 LEK (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind mijë Lekë), ("Zmadhimi i Kapitalit"). Zmadhimi i Kapitalit do të konsiderohet i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm në momentin e derdhjes së vlerës së sipërshtuar në llogarinë e Shoqërisë.



Pas një vlerësimi të kujdesshëm të çështjes së Rendit të Ditës, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë:

VENDOSI:

- A. Të miratojnë Zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet kontributit në para në vlerën prej prej 112,100,000 LEK (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind mijë Lekë).
- B. Zmadhimi i Kapitalit është i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm në momentin e këtij Vendimi
- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë, nga 10,000 Lekë (dhjetë mijë Lekë) do të bëhet 112,110,000 Lekë (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind e dhjetë mijë Lekë).
- D. Të autorizojë **Znj. Ledia Telhai**, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të Balfin Real Estate Sh.p.k., për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), ose të autorizojë persona të tjerë përkatësisht për këto veprime.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 12.00.


Ky procesverbal i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "**Balfin Real Estate**" SHPK mbahet në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
BALFIN REAL ESTATE SH.P.K.**

KRYETARI


Znj. Edlira MUKA

SEKRETARI


Z. Bers HADO

